



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 135, datë 13.09.2018

PËR

NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR ZBATIMIN E MASËS 64 TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit".

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 64 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të përbëhet nga:
 - ministri përgjegjës për diasporën kryetar;
 - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme anëtar;
 - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin anëtar;
 - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për financat anëtar;
 - titullari i Agjencisë Kombëtare për Diasporën anëtar.
3. Grupi ndërinstitucional i punës të kryejë vlerësimin për numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit, për fushat ku ata specializohen dhe të konsiderojë përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri për studentët të cilët marrin bursa studimi për jashtë vendit si dhe organizimin e informacionit e të mundësive për punësimin e tyre në vendlindje.
4. Grupi ndërinstitucional i punës të mblidhet cdo 3 (tre) muaj dhe të raportojë me shkrim në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën.



5. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A

